



SHPLLJE E REKRUTIMIT

Komuna e Kaçanikut, në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, më datë 19.04.2017 shpallë konkursin për plotësimin e vendit të lirë të punës:

I. TEKNIK I PYLLTARISË PËR MBROJTJE DHE MONITORIM

Drejtoria: Drejtoria për bujqësi, zhvillim rural dhe pylltari

Njësia/sektori – i pylltarisë

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës: koeficienti aktual- 6

Numri i referencës së vendit të punës: 01Nr.111/01-9765/17

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Është përgjegjës për organizimin e punës me rojet e rajoneve ekonomike për mbrojtjen e pyjeve nga faktori njeri, sëmundjet dhe dëmtuesit e ndryshëm 25%
2. Përcjellë rojet e rajoneve ekonomike rreth kryerjes së punës në mbrojtjen e pyjeve 15%
3. Harton plane për marrjen e masave për mbrojtjen e pyjeve nga dëmtuesit (prerësit ilegal) 10%
4. Propozon masa kundër rojeve të cilët nuk kryejn punët rreth mbrojtjes së pyjeve 10%
5. Propozon regjistrim të parakohshëm të tereneve ekonomike ku mendon se roja nuk ka kryer punët sipas ligjit apo dyshon se ka keqpërdorime 5%
6. Së bashku me rojet kontrollojnë operatorët ekonomik në ngastrat ku kryhen punimet, pa u përzier në kompetencat e inspektorit 15%
7. Në rastë paraqitjes së zjarrit lajmëron rojen në teren, të cilit i lajmërohet zjarri dhe lajmëron njësitin e zjarrfiksave dhe organet e rendit, teknikët tjerë dhe kordinatorin 5%
8. Ruan dhe mirëmban sistemin elektronik dhe kopjet fizike të dokumenteve dhe dosjeve të zyres së mbikqyerësit 15%
9. Përgadit raportet mujore për ngritjen e fletëparaqitjeve 5%
10. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikqyerësi: 5%

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

- Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilat kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

Procedura e konkurimit: është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

Shkollimi i kërkuar, Aftësitë, përvoja dhe attribute tjera që kërkohen:

- Arsimimi i mesëm, trajnim përkatës, tre (3) vite përvoj pune në fushën përkatëse
- Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës:
- Shkathtësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët:
- Aftësi koordinimi dhe mbikqyerje të punës për roje të pyllit
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel)

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kohëzgjatja e emërimit: pa afat të caktuar

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik, prej 19.04.2017 deri më 03.05.2017.

Paraqitja e kërkesave: Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar -Zyra e pranimit, kati përdhësë dhe në web-faqen komunale.

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten këto dokumente: Diplomën e shkollës së kryer apo Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën-ekstraktin e lindjes, vërtetimin e përvojës së punës, certifikata mbi trajnimet e kryera, dëshminë se nuk është në hetime.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”. “Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi

